

VENDIM
Nr.385, datë 15.4.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM
TË KOMUNËS KUMAN TË QARKUT TË FIERIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Kuman të qarkut të Fierit, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Kuman të qarkut të Fierit, miratuar me vendimin nr.481, datë 16.4.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Kuman të qarkut të Fierit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Kuman për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Kuman		Lidhja nr.1
Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-3	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji.	Në përdorim
4-14	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e mbrojtjes civile.	Në pronësi
15-22	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
23-26	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
27-30	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
31-40	Varrezat publike	Në pronësi
42, 46, 48	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
43,44,45,47,49,51,56, 65,78,87,89,93	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi
94-107	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
108-112	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi